# UNIVERSITETI I PRISHTINËS "HASAN PRISHTINA"
# FAKULTETI I EDUKIMIT FIZIK DHE I SPORTIT

## PUNIMIT I DIPLOMËS – MASTER

**RAPORTI NDËRMJET LOJTARËVE NË LOJËN E HENDBOLLIT**

**MENTORI:**
**Prof.Asis.Dr. Afrim Koca**

**KANDIDATI:**
**Halit Geci**

**Prishtinë, 2018**

## DEDIKIM

**Këtë punim ua dedikoj prindërve të mi që më ndihmuan që të arrij shkallën ku kam arritur.**

**PËRMBAJTJA**


1. HYRJE ........ 5

1.2 HULUMTIMET E GJERTANISHME ........ 14

1.3 PERSONALITETI I HENDBOLLISTËVE ........ 16

2. QËLLIMI I HULUMTIMIT DHE DETYRAT ........ 22

3. HIPOTEZAT THEMELORE ........ 23

4. METODOLOGJIA E PUNËS ........ 24

4.1. MOSTRA ETË TESTUARVE ........ 24

4.2 MOSTRA E VARIABLAVE ........ 25

4.2.1 Mostra e variablave dhe mënyra e matjes së testeve sociometrike. ........ 25

TESTI SOCIOMETRIK (Paranosic dhe Savic, 1977). ........ 26

4.3. METODAT E PËRPINIMIT TË REZULTATEVE ........ 28

5. INTERPRETIMI I REZULTATEVE ........ 29

5.1 REZULTATET NGA PYETSORI SOCIOMETRIK KH “DRITA” GJILAN ... 29

5.2 REZULTATET NGA PYETSORI SOCIOMETRIK KH “PRISHTINA” PRISHTINË ........ 32

5.3 REZULTATET NGA PYETSORI SOCIOMETRIK KH “KASTRIOTI” FERIZAJ ........ 35

5.4 DALLIMI NË MES LOJTARËVE MË TË VOTUAR DHE MË TË PA VOTUAR KH “DRITA” GJILAN ........ 38

5.5 DALLIMI NË MES LOJTARËVE MË TË VOTUAR DHE MË TË PA VOTUAR KH “PRISHTINA” PRISHTINË ........ 40

5.6 DALLIMI NË MES LOJTARËVE MË TË VOTUAR DHE MË TË PA VOTUAR KH “KASTRIOTI” FERIZAJ ........ 42

5.7 VËRTETIMI I HIPOTEZAVE ........ 44

6. PËRFUNDIMI ........ 45

7. LITERATURA ........................................................................................................ 48

REZYME ................................................................................................................... 50

SUMMARY ................................................................................................................ 51

# 1. HYRJE

Në kohën moderne, orientimi dhe përcaktimi i rinisë, për çdo sport, respektivisht për lojën e hendbollit është i kushtëzuar me dëshirën e vet të riut për këtë sport ose me anë të selekcionimit nga ana e ekspertit të lojës së hendbollit duke i marr parasyshë karakteristikat morfologjike për këtë sport, aftësitë psikomotorike, konative, kognitive, sociologjike si dhe shpejtësinë e të mësuarit dhe përsosjes së elementeve tekniko-taktike, (Fulgozi, 1994). Selekcionimi, përpos zgjedhjes që duhet bërë, nënkupton edhe orientimin dhe përsosjen e lojtarëve talent dhe hendbollistëve potencial kulmor (Paranosic dhe Savic, 1977). Ky është nji proces i gjatë dhe i ndërlikuar i cili kërkon punë ekipore dhe qëndrim multidisiplinar.

Suksesi në të gjitha sportet, pra edhe në hendboll, varet nga shumë faktorë ndërmjet veti të lidhura siq janë: aftësitë motorike, aftësitë kognitive, veçoritë konative, struktura motivuese, karakteristikat fiziologjiko-funksionale, dinamika e rrethit mikrosocial, elementeve tekniko-taktike të lojës, si dhe struktura morfologjike e lojtarit. Të gjitha këto gërshetohen në strukturë të përbashkët përgjegjëse për rezultatin sa më të mirë në lojën e hendbollit. Antropologjia është hapësirë shumë dimensionale, interaktive dhe se për këtë arsye përcaktimi i përshkrimit të atyre modeleve teorike të nën hapësirës relevante të cilat kanë ndikim të rëndësishëm në arritjen e sukseseve në lojën e hendbollit.

Për ta kuptuar më mirë dhe më lehtë qëndrimin kibernetik* të procesit stërvitor në kineziologji, këte mund ta bëjmë me rastin e analizimit të aktiviteteve sportive. Ekziston mundësia që të bëhet klasifikimi i caktuar i sporteve, me ndihmën e së cilave të gjitha sportet mund ti ndajmë në numër të caktuar të grupeve të ngjajshme (të përafërta), pasi që ligjshmëritë që vlejnë për një grup të aktiviteteve të ngjajshme ose të përafërta nuk do të thot domosdo se duhet të vlejnë për grupin tjetër.

* Me aplikimin e kibernetikës teorike dhe teknike në lëminë e sportit është zhvilluar nëndisiplina e kibernetikës aplikative e cila është emërtuar – kibernetika sportive (Leshko M., 1976).

Disa aktivitete kineziologjike (sportive) , të cilat në kohën e sotme kanë marr aplikim shumë të lartë ndërkombëtar, është e mundur, duke u bazuar në karakterin e aktiviteteve motorike të sportistëve, si dhe specifikat garuese ti ndajmë në pesë grupe të mëdha:

**I** – grupi i sporteve të cilat kanë ndikim të rëndësishëm në transformimin e statusit psikosomatik të sportistit ( atletika, noti, gjimnastika, sportet luftarake, skijimi, lojrat sportive dhe tjera të ngjajshme);

**II** – grupi i sporteve tek të cilat rezultati kryesisht varet nga kushtet teknike, veçanarisht burimeve të jashtme të energjisë (parashuta, automobilizmi, motociklizmi, lundrimi me anije me vela e tjera).

**III** – grupi i sporteve tek të cilat aktiviteti psikomotorik kryesisht i limituar me kushtet e gjujtjes së cakut nga arma speciale ose me anë të veglave (shejtaria, shigjetaria, gjuetia, kuglimi dhe të ngjajshme).

**IV** – grupi i sporteve tek të cilat merret parasyshë krahasimi i rezultateve aktivitetet e modelimit dhe konstrukcionit të sportistëve (aviomodelet, automodelet dhe të ngjajshme).

**V** – grupi i sporteve përmbajtja garuese i të cilave bazohet në garën logjiko-apstrakte (shahu).

Pasi që disa grupe të lartpërmendura (2, 3, 4 dhe 5) të sporteve nuk kanë ndikim të rëndësishëm (ose ndikimi i tyre është i parëndësishëm) në statusin psikosomatik të sportistit ato mund të mospërfillen në analizën në vazhdim. Sportet të cilat kanë ndikim të rëndësishëm në transformimin e statusit psikosomatik të sportistit ( grupa I) mund të ndahet në tri nëngrupe kryesore*:

**(1.) Sportet monostrukturale** në të cilat dominon struktura e tipit ciklik apo aciklik.

**a) Sportet aciklike** në esncën e së cilave ose esenca e së cilave është konflikti direk me kundërshtarin dhe destrukcioni simbolik i kundërshtarit (kërcimet në atletik dhe gjuajtjet, ushtrimet në vegla, ngritja e peshave, kërcimet në ujë, kërcimet me ski e tjera).

* Përshkrimi më i gjerë gjendet në librin "Osnove sportskog treninga" nga autori : Julian Malacko, Sportska knjiga ,1986, Beograd.

**b)** **Sportet ciklike** në esncën e së cilave ose esenca e së cilave është përsëritja e lëvizjeve të ngjajshme (vrapimet në atletikë, notimi, kajaku, biciklizmi, vrapimet me ski e tjera);

**(2)** **Sportet polistrukturale** në të cilat dominon struktura komplekse e tipit ciklik apo aciklik në esencën e së cilës është variabiliteti, me prezencën e shumë faktorëve të ndryshëm:

**a)** **Sportet aciklike** në esncën e së cilave ose esenca e së cilave është konflikti direk me kundërshtarin dhe destrukcioni simbolik i kundërshtarit (boksi, mundja, gjudo, karate e tjera),

**b)** **Sportet komplekse** në esncën e së cilave ose esenca e së cilave është natyra e lëvizjes komplekse, duke përfshirë lëvizjet e tipit ciklik apo aciklik dhe se tek te cilat rezultati varet nga kooperimi i anëtarëve të grupit (lojrat sportive dhe të ngjajshme),

**c)** **Sportet konvencionale** në esncën e së cilave ose esenca e së cilave lëvizja aciklike në harmoni me ndonjë kriterium estetik (gjimnastika ritmiko-sportive, patinazhi artistik, noti i sinkronizuar);

**(3)** **Sportet komplekse** tek të cilat dominojnë përmbajtjet e vazhdueshme (shumëgarshat në atletikë, triatloni dhe të ngjajshme).

Zbulimi i rregullave të sjelljeve dhe ruajtjes së harmonisë së grupit në ekipet kulmore të hendbollit dhe ndikimit të këtyre rregullave të sjelljeve në arritjen e suksesit në lojën e hendbollit paraqet njërën prej detyrave të rëndësishme të antropologjisë e në veçanti të sociologjisë në lëmin e sportit.

Nevojat dhe qëllimet e ndryshme i diferencojnë grupet në hapësirat e ndryshme dhe veprojnë në ligjshmëritë e veprimeve të tyre. Gjerë më sot në hapësirën e dinamikës së grupit, si hapësirë sociologjike, nuk është dhënë asnjë teori konkrete në të cilin kishin mundur të mbështeten edhe hulumtimet e ekipeve sportive.

Ndër shkaqet e shumta për këso gjendje është hapësira relativisht e re, si dhe qëndrimi ndaj grupeve të shumta në të cilat njerzit shoqërohen me qëllim të plotësimit të nevojave të shumta për këso gjendje nga aspekti i shkencave të ndryshme.

Nëse kësaj i shtohen teori të përgjithshme të ndryshme mbi grupet të cilat kanë dalur nga drejtimet sociologjike, dhe qëndrimet e së cilës në disa hulumtime të cilat janë marrur si pikënisje, është i kuptueshëm mendimi i disa teoriticientëve që hulumtimet e gjertanishme të grupes dinamike vlejnë vetëm për grupet e hulumtuara ose nëse rezultatet edhe mund të gjeneralizohen vetëm në hapësirë të caktuar (sociologji e sportit, sociologjia e familjes, ekonomi, psikologjia sociale e tjera).

Kjo megjithat, nuk nënkupton që rezultatet e caktuara dhe hulumtimet e kryera me grupe të vogla nga aspektet e ndryshme nuk mund të jenë të përdorshme edhe në hapësirat tjera, pra edhe në hulumtimet e grupeve në sporte të ndryshme.

Nevojat gjatë lojës, si shkak kryesor të ndërlidhjes në mes të njerzve në grupe shoqërore , janë ato të cilat definojnë ligjshmëritë e dinamikës së grupit të grupeve të caktuara. Grupet dinamike në aktivitetet sportive, domethënë, në kuadër të kësaj ekipet kulminore sportive i përmbushin nevojat të cilat janë karakteristikë për sportin kulminor. Kështu në kuadër të determinimit shoqëror realizohen sisteme specifike sociale (ekipe kulminore) të cilat në interakcione të lojtarëve të tyre dhe interakcione të vet grupeve sportive tregojnë mostra stabile të caktuara të sjelljeve.

Hulumtimet sa i përket homogjenitetit dhe kohezionit të grupes dinamike në aktivitetet sportive, konkretisht në lojën e hendbollit, testohen me anë të procedurave të ndryshme sociometrike. Këto procedura qojnë drejt realizimit të qëllimeve të çdo hulumtimi të kësaj natyre. Sociometria është shkencë e cila merret me hulumtimin e raporteve kualitative dhe kuantitative në kuadër të grupës. Sociometria ofron informacione për rrethin në të cilin përsoni i caktuar pëlqehet apo jo nga anëtarët të cilët hulumtohen (lojtarët e lojës së hendbollit). Kjo arrihet me anë të anketimit e cila anketë përmban pyetje të tilla të konstruktuara, në të cilat nga anëtarët kërkohet që të shprehen me shkrim, respektivisht, që të emrojnë partnerin më të dëshiruar në situata të caktuara.

Hendbolli paraqet sport kompleks i cili nga dita në ditë gjith e më tepër po zhvillohet. Grupi i lojtarëve me kualitete të ndryshme basketbollistike, temperamente, qëndrime, duhet të komponohet ashtu që të funksionojë si një tërësi, respektivisht,

mekanizmi në të cilin  secili e ka rolin e vet në rrugën drejt realizimit të qëllimit të caktuar. Gjatë zhvillimit të këtij sporti kujdes më i veçant iu është kushtuar teknikës, taktikës dhe përgatitjes fizike të hendbollistëve. Sot kur segmentet e përmendura më lartë të lojës së basketbollit kanë arritur deri në një shkallë të kënaqshëm apo të lakmueshme, mbizotrimi në konfliktet ndërmjet vete në ekipë sjellë kompaktitet (kohezion) ekipes. Në lojërat plotë emocione, me kthime në rezultate, presioni i publikut dhe fitorja si imperativ, ekipa psiqikisht stabile ka shansa më të larta për fitore.  Ekipa e përbërë nga lojtarët me raporte interpërsonale të forta të inkorporuara në motivin e lartë për fitore, do të ketë përparësi, e cila sa do që të duket minimale mund të sjell rezultate të dëshiruar.

Që të jetë ekipi kompakt dhe që lojtarët të realizojnë lidhje të forta emocionale, është e domosdoshme të punojmë më gjatë dhe më shumë, të ketë stërvitje kualitative, bisedime shoqërore dhe kshillime. Kjo është e mundshme që të arrihet vetëm pas analizimit të struktures sociometrike të ekipit, dhe  konstatimi i situatës sociometrike momentale.

Hendbolli është specifik sipas asaj  që shpesh një gabim mund të vendos për rrjedhën e lojës. Nuk ekzistojnë shansat për përmirësim. Trajnerët duhet të mbajnë nivelin e motivimit tek lojtarët e vet  gjatë gjithë lojës  ashtu që kundërshtari me rezultat mos të shmanget, ose ashtu që ekipa të mbaj përparësin në rezultat ndaj ekipes kundërshtare. Shpesh në gara (gjatë lojës) mund të vërejmë oscilimi të rezultatit, nga udhëheqja e dukshme deri tek ngecja evidente dhe anasjelltasi. Në këto situate shikohet përgaditja fizike dhe psikologjike e ekipit, kohezioni, forca e ekipes dhe udhëheqja e mirë e trajnerit.

Hulumtimet sociometrike në hapësirën tonë në lëmin e  hendbollit nuk janë krye. Ekziston hapësirë e madhe  për hulumtime në këtë drejtim, si në qëllim të kontributit  të njohurive teorike ashtu edhe në vërtetimin praktik dhe aplikimin eventual të mëtutjeshëm.

**Shqyrtimi  teorike i testit sociometrik –** Gjatë jetës, individi hynë në shkallë të ndryshme të interreakcioneve me njerzë të tjerë dhe përfshihet ose merr pjesë në bashkësi të ndryshme formale apo jo formale. Që me sukses ti bashkangjitet dhe ti përshtatet

grupit, është shumë e rëndësishme që të vendos raporte adekuate. Pikërisht me këta persona me të cilët e përbëjmë grupin çdo ditë komunikojmë dhe punojmë së bashku në zgjidhjen e shumë problemeve.

Çdo individ kontakton me numër të caktuar të përsonave dhe kjo paraqet hapësirën e tij sociale. Në varësi nga karakteri i vet, individi më tepër ose më pak është i hapur ndaj njerzëve me të cilët hynë në kontakt (ekstrabesueshmëri dhe interbesueshmëri). Përsonat e një grupi dallohen ndërmjet veti edhe sipas statusit sociometrik, do të thot, popullaritetin që e kanë në atë grup. Shpesh herë pikërisht ky faktor përcakton sjelljen intraverte ose ekstraverte të një individi.

Me hulumtimin e statusit sociometrik dhe qeltërsinë emocionale merret hulumtimi sociometrik të cilën në psikologji e ka aplikuar Moreno (Moreno, 1916). Ky autor në hulumtimet e veta ka studiuar raportet emocionale në grup, tërhjekjen (bashkimin) ose ndarjen e anëtarve të grupit, dhe në bazë të rezultateve të fituara e ka definuar strukturën emocionale me anë të sociogramit. Moreno thellë ka besuar se grupet shoqërore mund të organizohen dhe reorganizohen në principet tërheqjes (afrimit) dhe refuzimit (simpatit dhe antipatitë). Hulumtimet e shumta të cilat i ka realizuar, nuk kan pasur për qëllim vetëm njoftimin e pastër teorik me strukturën psikologjike të grupit, por, gjithashtu edhe qëllim praktik. Moreno ka konsideruar se në bazë të sociogramit si përfaqsues të strukturës sociometrike të grupit, individët mund të organizohen në grupe në bazë të dëshirës dhe nevojave të tyre. Gjitha hulumtimet e më vonshme të cilat janë bazuar në ligjshmëritë e sociometrisë, janë krye në: familje, shkolla, ushtri, industri, baza fetare, politikë dhe tjera.

**Statusi sociometrik** – Statusi sociometrik tregon përkrahjen e individit nga ana e grupit të caktuar, edhe ate se si individi në aspektin social i përshtatet grupit. Përshtatja sociale përcaktohet me procedura të ndryshme sociometrike. Në këto teknika merr pjesë ose aplikohet testi sociometrik, si mjet për studimin e grupeve familiare, shkollore, sportive, punuese e tjera. Metodën sociometrike e ka zhvillue J.L. Moreno në vitin 1934. Sipas tij socometria mund të shfrytëzohet si: teknikë hulumtuese e cila shërben për hulumtimin e organizimit të grupes ose grupeve, procedurë diagnostifikuese me të cilën

duhet të përcaktohet pozita e individit në grup dhe pozita e grupit në bashkësin e gjerë shoqërore ose teknika psikoterapeutike e cila i mundëson individit ose grupit që më mire të përshtatet. Aktivitetet për pjesëmarrje në të cilat hulumtohet raporti i përkrahjes ose refuzimit quhen kriteriume sociometrike. Në hulumtimet sociometrike mund të shfrytëzohet një ose më tepër kriteriume. Kriteriumet duhet të jenë logjike dhe duhet të ken të bëjnë në aktivitetet të rëndësishme për individët.

Hulumtimi ekzekutohet në grupe të vogla, dhe kushti për aplikim është që të testuarit në mes veti të njihen dhe se së bashku kan kaluar një kohë relativisht të gjatë. E dëshiruar është që të testuarit të jenë anonim (gjatë testimit most e tregojnë emrin dhe mbiemrin apo karakteristika tjera identifikuese). Shënimet të fituara me anë të hulumtimit sociometrik mund të paraqiten në mënyrë kuantitative (matricat socometrike, indekse grupore apo individuale) dhe grafikisht (sociogrami). Në rastin e grupit më të madh sociogrami është i pa përshtatshëm dhe se në këto raste nuk shfrytëzohet.

**Testi sociometrik –** Testi sociometrik është mjet me të cilën studiohet ose hulumtohet struktura shoqërore në pikëpamje të tërheqjes ose refuzimit të shprehur në grup. Testi sociometrik mundëson analizën kuantitative të struktures emocionale të grupes në kuptimin e përkrahjes së individve në grup. Ky është operacioni i parë strategjik i cili është i përshtatur për depërtim më të thellë në strukturën e grupes, sepse hulumton ose studion strukturën jo formale (psikologjike) (Sipas Morenos, 1962 : 43). Për dallim prej struktures formale të grupes, e cila nga jasht është e imponuar anëtarëve të grupes, e përbëhet prej hijerarkisë së roleve, ndikimit dhe forcës, struktura joformale e grupes përbën gjithë ate që anëtarët e grupit i fusin nga brenda, dhe paraqet bazën për funksionimin e grupes si tërësi.

Strukturën joformale të grupes e përbëjnë vlerat orientuese, percepcionet e anëtarëve tjerë të grupes, të kuptuarit ndërmjet veti, vlerësimi i ndërsjellt dhe vetvlerësimi.

Përparsia e këtij testi  në raport me testet psikometrike (testet e rolit, psikodrama e tjera) shikohet në esencë që situatat  e marrura me mend zavendësohen me situate natyrore të cilat lajmërohen në jetën e përditshme.

Ekzistojnë shumë lloje të teknikave sociometrike:

a) Teknika e emrimit – çdo anëtarë në grupin e hulumtuar emron numër më të vogël të anëtarëve tjerë të cilët më së tepërmi, më së paku i pëlqen ose me të cilët deshiron, nuk deshiron të merr pjesë në ndonjë aktivitet,
b) Teknika e vlerësimit me shkallë – të testuarve i u ipet detyra që çdo anëtar i grupit vlerësohet në shkallë prej 1 deri 3 ose prej 1 deri 5 në raport me ndonjë kriterium të caktuar.
c) Teknika e krahasimit në çifte – çdo të testuari i ofrohet  lista e kombinimeve  e gjithë çifteve të mundshëm në grup, gjatë së cilës i testuari në çift thekson anëtarin të cilin e preferon.

Ekzistojnë dy kriteriume themelore tek të gjitha teknikat sociometrike:

- Kriteriumi funksional – sipas këtij kriteriumi zgjedhja ose vlerësimi kryhet në bazë të veçorive të caktuara  të domosdoshme për aktivitetin specifik (para se gjithash mendohet në veçoritë të cilat theksojnë funksionimin e mire në grup).
- Kriteriumi emocional – tek ky kriterium zgjedhja  ose vlerësimi kryhet në bazë të raporteve ndërmjet veti të tërheqjes (përkrahjes) dhe refuzimit.

Validiteti i testit sociometrik varet nga përshtatja adekuate të pyetsorit sociometrik të grupit në të cilën kryhet hulumtimi. Pyetsori sociometrik është shumë i përshtatur grupeve të ndryshme dhe shfrytëzohet në fusha të ndryshme të veprimtarisë së njeriut: në industri, shkolla, familje, institucione ushtarake, klube sportive e tjera.

Aplikohet gjithkund ku ekziston kolektiv i caktuar, ose më gjërë duhet të formojmë në kuadër të kolektivit të formuar. Në formën më të thjeshtë pyetsori sociometrik përmban pyetje të drejtuara çdo anëtari të grupit që të shënoj ndër anëtarë tjerë të grupit ata me të cilët kishte pasur deshirë të merr pjesë në ndonjë aktivitet ose ata

me të cilët nuk kishte pasur deshirë. Me këte të testuarit mund të shprehen (çka varet nga natyra e pyetsorit) me qëndrimet e veta pozitive, negative apo neutrale të cilat i kanë ndaj anëtarëve tjerë të grupit. Kundërshtarët e zgjedhur negativ përfaqësojnë qëndrimin që zgjedhje të tilla shkaktojnë rezistencë tek testuesi, sepse individët e caktuar nuk deshirojnë të pranojnë ndieshmërinë e vet negative ndaj individve tjer në kuadër të grupes së njejt. Shkaku i raportit ndaj zgjedhjes negative nuk është qartë e definuar por mendohet që individët ndiejn jo knaqësi dhe që nuk dëshirojnë të jenë në pozitë të tilla, as të përjetojnë ndjenja të tilla. Mbrojtsit e zgjedhjeve negative theksojnë se vetëm me kombinimin e zgjedhjeve pozitive dhe negative mund të vihet deri te shënimet e pasqyrës e cila realisht definon raportet të cilat mbretrojnë në grup. Sipas mendimit të tyre ndarja e njëres nga dy zgjedhjet e mundshme, do të sjell deri tek të dhënat, interpretimi i të cilave do të tregon pasqyrën e lakuar e raporteve në grup.

## 1.2 HULUMTIMET E GJERTANISHME

Tendenca që në raportet në ekipet sportive të vrerësohen në mënyrë ekzakte dhe matëse ka kontribuar që në psikologjinë e sportit të vendosen teknika të ngjajshme ose modifikuese të testeve sociometrike të J. Morenos.

J. Moreno qysh në vitin 1916 konceptin e tij mbi sociometrinë e ka dhënë në formulimin siç vijon: >> Rrymimet pozitive dhe negative si dhe ndijshmërit në kuadër të një grupi mund të zbulohen me anë të analizës sociometrike<<.

F. E. Fielder në vitin 1954 ka propozuar shkallën për matjen e raporteve interpersonale të quajtur AS-shkalla. Në disa hulumtime në bazë të AS-shkallës së parashtruar autori ka kërkuar lidhshmërinë ndërmjet variablave interpersonale të përkrajes dhe suksesit të ekipes të definuar me kritere të caktuara. Vlerësimi i tij general është se suksesi i grupes është në korelacion pozitiv me percepcionet interpersonale të anëtarëve të grupit.

A. Myers mendon se vetëm kërkimet shkencore japin përgjegje mbi efektin e garave në raporte interpersonale dhe të përshtatjes.

J. R. Mc Grath në eksperimentin në të cilin kanë marr pjesë sportistët, gjygjëtarët, e ka formuar grupin në bazë të dy testeve me anë të të cilave ka matur raportet pozitive dhe negative interpersonale. Eksperimenti i cili ka zgjatur pesë javë ka treguar se grupin të cilin e ka quajtur NIR (Nonpositive Interpersonal Relation) ka arritur rezultate më të mira dhe ka treguar përparim më të theksuar se sa grupa e quajtur PIR (Positiv Interpersonal Relation).

M. Despot në vitin 1967 ndër të parët në ish Jugosllavi ka tentuar të aplikojë teknikën sociometrike për të testuar një klub të futbollit, ashtu që të verifikojë mundësinë e aplikimit të kësaj teknike tek analizat psiko-sociologjike të klubeve të futbollit.

K. Petroviç dhe M. Pavloviç në vitin 1969 kanë përdorur teknikën e shkallëzimit dhe sociometrinë tek hulumtimet të raporteve natyrore dhe proceseve në një klub

basketbollistik të rangut të lartë. Hulumtimi ka treguar se teknikat sociometrike janë të pamjaftueshme për analizimin e raporteve dhe proceseve, sepse analiza e vërtet sociologjike duhet të fillojë nga këto të dhëna.

K. Petroviç (1972) në një hulumtim në një mostër të selekcionuar të ekipeve basketbollistike më të mirat të ligës së parë për meshkuj në ish Jugosllavi (në tetë vitet e fundit) me ndihmën e anlizës faktoriale dhe modeleve të veçanta matematikore të struktures kineziologjike të grupit dhe analizës regresive ka izoluar shtatë dimensione latente, karakteristike për sjelljet e mostrës relativisht stabile tek klubet basketbollistike të rangut të lartë. Dimensionet e izoluara latente në masë të mjaftueshme tregojnë dhe sçarojnë dinamikën e grupes, strukturën mikrosociale të grupes dhe statusun mikrosocial të grupes.

## 1.3 PERSONALITETI I HENDBOLLISTËVE

Tërësitë e të gjitha veçorive ose cilësive të cilat i posedon personi i caktuar, e përbëjnë personalitetin e tij, respektivishtë strukturën e personalitetit. Struktura e personalitetit është shumë e ndërlikuar, sepse çdo personalitet përbëhet prej shumë veçorive të ndryshme të cilat e përbëjnë. Është shumë vështirë të vërtetohet numri i këtyre veçorive ose cilësive, dhe se në mesin e shumë hulumtuesve ekzistojnë pa pajtueshmëri edhe rreth klasifikimi veçorive të përsonalitetit. Duhet, domethënë të kemi parasyshë se personi nuk është tërësi e thjeshtë e veçorive. Ky është organizim i ndërlikuar e cila funksionon si tërësi.

Struktura e personalitetit të hendbollistit është mjaftë e rëndësishme, duke pasur parasyshë ate se identifikimi i anëtarëve të ekipes është intensive. Nga veçoritë ose cilësitë të cilat e përbëjnë personalitetin e tij, në të shumtën varet kur dhe në ç'masë sportisti i caktuar identifikohet me lojtarët tjerë, sjelljet e tij, qëndrimet, kërkesat, vlerat për të cilat mundohet e tjera. Duke pasur parasyshë që është e pamundur të analizohet sruktura komplete e personalitetit, do të ndalemi në disa veçori të përsonalitetit të karateistit të cilat janë më të rëndësishme, duke mos nbajtur ndonjë klasifikim rigoroz të përsonalitetit.

Intelegjenca është njëra nga veçoritë nga e cila varet suksesi në kryerjen e cilës do punë, cilit do rol, pra edhe rolit të garuesit, si dhe punës professional dhe pedagogjik të tij. Ajo mundëson që garuesi shpejtë të gjendet në situate të ndryshme të reja në punë dhe në mënyrë adekuate të reagojë atëherë kur prej tij kërkohet që të sjell vendime të ndryshme. Intelegjenca e karatistit duhet të jetë diqka më e lartë nga mesatarja e lojtarëve të sporteve tjera. Njerzit intelegjent, mesatarisht janë organizatorë më të mire dhe janë më racional në situate të caktuara. Ata hyjnë më thellë në problemet e analizimit të situatave, në esencën e problemeve të tyre dhe në shkaqet e sjelljeve në situata adekuate dhe jo adekuate. Ata gjithashtu janë të ndryshëm në gjetjen e masave të caktuara pedagogjike dhe zgjidhjeve në punë dhe me kreativitetin dhe krijimtarin e tyre shtyjnë ose potencojnë llojllojshmërinë dhe origjinalitetin.

Natyrisht, intelegjenca, si veçori e porsonalitetit, nuk është e mjaftueshme për sukses. Ajo vjen në shprehje nëse gjendet në kombinim me veçoritë tjera pozitive të përsonalitetit.karatisti duhet të ket talent ideor me të cilën nënkuptojmë aftësinë e zbulimit e ideve dhe zgjedhjeve të reja për probleme të caktuara ose suksesshmërinë e aplikimit ose modifikimit e ideve dhe zgjedhjeve të vjetra, me të cilat, në situate konkrete i shtohen elementet e reja, e me këte edhe vlera të reja.

Krahas kësaj, është i domosdoshëm, i ashtuquajturi talenti organizues, me të cilën nënkuptojmë "aftësinë e udhëheqjes të organizimit dhe structures të till me të cilën mund më me sukses të aplikohet në jetë disa ide të vjetra apo të reja, respektivisht, respektivisht të zgjedhim ndonjë problema apo apo detyrë" (Zvonarevoc, 1966). Puna e karatistit kërkonë personalitet ambiciozë. Ambicioziteti është veçori e mirë se ardhur edhe kur është në pyetje vet përparimi dhe përsosja profesionale, edhe kur është në pyetje organizimi i punës njohja e personalitetit të sportistit dhe gjetja e masave dhe zgjedhjeve adekuate pedagogjike dhe psikologjike.

Roli i nderlikuar dhe shumë me përgjegjësi i trajnerit është në kundërshtim me personalitetin pasiv, inert, jo inciativ dhe joambicioz. Traineri pasiv dhe jo anbicioz kryesisht mendon që ekipa është "barrë e rëndë" dhe se nuk mund të arrihet ndonjë rezultat i rëndësishëm. Ambicja mund të jetë e tepruar, jo reale dhe në mënyrë joadekuate e orientuar. Atëherë ajo i afrohet personit ambicioz të sëmurë.

Nëse ajo te trajneri percjellet me ndjenja jo gabueshmëri, me gjithë njohuri, me pazavendsueshmëri, vetëkënaqësi, atëherë kjo negativisht mund të shprehet në kontributin në punë dhe në veçoritë e personalitetit të sportistit me të cilin punon trajneri.

Stabiliteti emocional është veçori e cila është e nevojshme çdo njeriu, veçanarisht hendbollistët. Këte po e theksojmë për arsye se mënyra e reagimit emocional i hendbollistit dhe manifestimi i emocioneve pjesërisht mësohen, do të thot socializohen dhe lehtë bartën te hendbollisti. Stabiliteti emocional i mjaftueshëm nënkuptohet edhe si nivel adekuat të tolerances frustruese dhe rezistencën në mos sukses dhe frustracion.

Veçoria e drejtësisë është veçanarisht vetia e deshiruar të cilën hendbollistët e kërkojn tek trenerët e tyre. Shumë është e ndërlikuar deri në fund në mënyrë të barabart të trajtohet çdo anëtar në ekipë dhe të mos bëhet asgjë që të mundësohet të përfundohet që në sytë e trajnerit nuk janë të barabart dhe në ekip ka të privilegjuar dhe se kjo privilegjë të shkojë në llogari të individit. Edhe kjo situat te karatistë duhet të tejkalohet duke mos lënë gjurmë negative në suksesin e tij.

Anksioziteti - nëqoftëse gjatë historisë së njerzimit, ndonjëherë ka ekzistuar anksioziteti atëherë ajo pikërisht po ndodh tani. Ndjenjat si siç janë: anksioziteti, nervozizmi, shqetësimi i brendshëm, frika, ankthi, tensioni i vazhdueshëm, frika për të ardhmen, depresioni, dobësi fizike e tjera. Secili prej nesh ka një përvojë me këto ndjenja, por te disa njerëz ajo zhvillohet aq sa arrinë nivele të patolerueshme të frikës konstante dhe sulme të tmerrshme paniku.

Anksioziteti është frika nga e panjohura që në sporte të ndryshme e sidomos në sportin e karatesë ndikon negativisht në rezultatin përfundimtar. Në qoftë se gjatë historisë së njerzimit, ndonjëherë ka ekzistuar anksioziteti atëherë ajo pikërisht po ndodh tani. Ndjenjat siç janë: anksioziteti, agresiviteti nervozizmi, shqetësimi i brendshëm, frika, ankthi, tensioni i vazhdueshëm, frika për të ardhmen, depresioni, dobësa fizike janë ndjenja që e përcjellin njeriun e të gjitha moshave e sidomos ate gjatë kohës së shkollimit. Secili prej nesh ka një përvojë me këto ndjenja, por te disa njerëz ajo zhvillohet aq sa arrinë nivele të patolerueshme të frikës konstante dhe sulme të tmerrshme paniku.

Anksioziteti është një gjendje e pakëndshme që karakterizohet nga një ndjenjë e vazhdueshme e ankthit dhe frikës se diçka e tmerrshme do të ndodhë. Këtë dukuri e përcjell tensioni i pakëndshëm fizike në tërë trupin dhe shqetësime të jashtëzakonshme të brendshme. Personi shpesh ka ndjenjën se do të "shpërthejnë", se është duke humbur kontrollin mbi veten, se do ti ndodhë diçka "e tmerrshme".

Anksioziteti gjendja e frikës së papërcaktuar, të pasigurisë dhe ankthit, sipas shumë autorëve, sajon bazën e sjelljes neurotike. Shembujt karakteristikë të stimulusit, që e ngrërthen testi, ku në bazë të së cilave ka qenë e mundshme të vlerësohet anksioziteti, ishin këto: jam i vetmuar vazhdimisht, i shqetësuar për diçka, jam zakonisht shumë i

kujdesshëm, shpesh herë habitem dhe ngatërrohem, kur lypset të punoj shpe-jt,  djersitem gjithmonë dhe dridhem fort, kur dikush kontrollonpunën time, ose gjatë kohës së ndonjë provimi,  ndjehem më mirë, kur e di se mund të kërkoj ndihmë ose këshillë nga ndokush.

Agresiviteti – dështimi për të kënaqur motivet e caktuara mund të ketë pasoja negative në jetën mendore dhe sjelljes. Shumë shpesh reagimi në dështim (josukses) është  agresivitet. Dështimi shkakton jo vetëm jodisponim por edhe zemërimin. Kërkohet dikush  tek i cili do të kërkohet preteksi për ta sulmuar si fajtor për dështimin e vet, ose dikend tek i cili do ta zbrazë zemërimin. Shprehja e agresivitetit ul tensionin mendor, por shpesh  çon në konflikt, dhe asnjëhere nuk zgjidh problemin. Agresiviteti është forca e supozuar biologjike ose psikologjike, motiv në aspektin e shtytjes apo nevojës,  i cili qëndron pas sjelljes së dukshme, të hapur ose të fshehtë agresive. Koncepti i agresionit është i dykuptimtë, sepse njëkohësisht  tregon shpirtin luftarak,  energjinë, iniciativën, nevojën për vetë-pohim dhe poshtërimin e tjetrit.

Sipas (F. Trebjesanin, 2005. ) Agresioni është një fenomen dhe gjendje komplekse e cila në pikëpamje motivues manifestohet emocionalish dhe në aspektin veprues si nxitje, zemërim, hidhërim, armiqësi, përvetësim dhe sulmin daj personit, pronës, territorit, dhe grupit dhe më gjerë.  Kjo është një veti biologjike dhe psikologjike bazë në  instinktin e vetruajtjes dhe angazhimi kah afirmimi i personalitetit; manifestohet në akte të sulmit në  gjithçka që e pengon  ose mund të pengojë përmbushjen e nevojave jetësore, por edhe të dëmtojnë prestigjin social, suksesin, lirinë e veprimit, etj.

Në lojën e hendbollit , përgatitjen  teknike, përgatitjen taktike , sociologjike dhe psikologjike reciprokisht mbivendosen, duke bërë praktikën unike, dhe në të njëjtën kohë të rëndësishme, dejtimin stërvitor psikologjike dhe taktike. Rëndësia të madhe kanë proceset psikologjike – e njohurive dhe intelektuale, (vëmendja perceptimi, të menduarit operative, etj.) Trajningu me ndikim psikologjik fillon me krijimin e atmosferës pozitive, konkrete dhe të bazuar në rethana në lidhje me atë se çka dëshirojme me realizuar me kalimin e kohës të nevojshëm. Këto gjëra nuk do të duhej të jenë qëllimet e vetme që na bëjnë të ndihemi mirë në të tashmen , por ato paraqesin model të mire për të ardhmen.

Gjatë trajningjeve karatisti udhëheqet me nivel të vetëdijes të lartë që në të njejtën kohë jep motiv , energji dhe vullnet të madh për synimin dhe objektivin e vet për të arritur përsoshmërinë sa më të mirë .

- Ekipi dallohet me vullnet dhe fuqi të madhe të orjentuar drejt fitores.
- Komunikimi i hapur dhe shumë i sinqertë krijon mirëkuptim dhe fuqi më të madhe.
- Dija dhe puna profesionale është më e rëndësishmja që aplikohet në trajningje.
- Shkathtësitë – mjeshtërite fitohen përmes ushtrimeve dhe trejningjeve të shumta.
- Ky është treguesi kryesor për të arritur objektivin.
- Flesksibiliteti dhe kreativiteti ofrojnë qasje më të mira të synimeve.

Me trajningje zhvillohen aftësitë e garuesve në mënyë individuale sidomos ato të cilët janë më të mirë në ekipë. Ata janë që e rregullojnë tensionin, vetëbesimin gjatë trajningjeve të rregullta. Trajneri i arsyeshëm i koordinon në mënyrë të drejtë dhe profesionale duke i udhëhequr me një strategji, vullnet dhe motiv të lartë . Kombinimi në mes aftësive personale dhe fuqisë mentale është ajo çfarë e karakterizon ekipin punues ,me cilësi të larta që funksionon duke i mbuluar të gjitha organizmat në ekip. Me edukim menjanojmë çdo mohim sepse ajo egsiston vetëm ne gjuhë. Bisedimet – komentimet, diskutimet janë që i dëshirojnë karatistët por më shumë duhet diskutuar në lidhje me theksimin e gabimeve që ato të mos përsëriten .

Shpeshëherë ne kritikojmë me rrezistencë të përgjithshme për ndryshime pasi që shumica e hendbollistëve janë të ndjeshëm dhe reagojnë ashpër në kritika që iu bëhen . “Kurrë mos puno kundër diçkaje, por gjithmonë për diçka”. Mos bë luftë, por paqe. Dallimi në mes këtyre dy formulimeve të synimeve është në fakt shumë i madh . Andaj është e udhës të paraqitet me një sygjerim më të mirë .Trajneri edukon në mënyrë të drejtë për të tashmen dhe të ardhmen – e ardhmja është tani! Kur flet ndonjë person për gjatë përgatitjeve për gjëra jo interesante, trajneri duhet thënë “Mendoj se nuk duhet të hargjojmë kohë në lidhje me atë “.

Në vend të kësaj mundemi me trajtuar dy gjëra të tjera : “Si do te jemi të përgatitur për gara?” dhe “Si do të donim që të ishin ato?”. “Është një rregullë e vogël ,

asnjë nga ju nuk bëni të flisni për humbjet në të kaluarën. Mund të flisni vetëm për të tashmen dhe të ardhmen”. Trajningjet të organizuara në mënyrë profesionale ndikojnë në zhvillimin e karakterit , moralit dhe edukimit të veçantë sportiv. Pegaditje fizike dhe psikologjike si dhe aspekti social konsiston në zhvillimin e atyre aftësive që drejtpërsëdrejti marrin pjesë në arritjen e rezultateve. Mund të përdoren ushtrime garuese në bazë të rregullave të garave apo përdorimin e pajisjeve të veçanta që mund të sigurojnë përshtatje të mirë gjatë trajnimit. Në sportin e karatesë përdoren props mjeteve ndihmëse (pesha rrip, thes të rëndë, thes të lehtë, lloje të ndryshme biçikleta, litar e tjera. Ndërsa, për zbatimin e stërvitjeve ose ushtrimeve garuese janë prezente ushtrimet shkollore, të lira dhe të përzgjedhua Shkollore (sipas marrvshjes) lufta konsiston në realizimin e konceptit të luftës që e ka parashtruar trajneri para fillimit të saj. Janë përcaktuar paraprakisht: koha, rregullat dhe format e sjelljeve e konkurentëve.

## 2. QËLLIMI I HULUMTIMIT DHE DETYRAT

Loja e hendbollit bënë pjesë në kuadër të sporteve ekipore ose grupore. Çdo grup përbëhet nga numri i caktuar i individëve të cilët dallohen sipas qëndrimit, temperamentit, arsimimit, motiveve, shkallës arsimore, gjendjes ekonomike e tjera. Për këtë, për grupin mund të thuhet se paraqet zingjirin të cilin e përbëjnë shkallët të përbëra nga materialet e ndryshme. Në këtë hulumtim do të përfshihen hendbollistët si individ të cilët me raportet ndërmjet veti dhe me veprim të përbashkët përbëjnë një grup-ekipë. Do të hulumtohen raportet ndërmjet lojtarëve në kuptimin e tërheqjes (afrimit) dhe refuzimit sipas esencës së kriteriumit specifike për hendbollistë. Ndoshta ky proces i hulumtimit të struktures sociometrike të ekipeve të hendbollit mund të krahasohet me procedurën e inqizimit me rentgen, ku vërehen edhe detajet më të imëta.

Qëllimi i këtij studim do të jetë hulumtimi i struktura së grupit në kuptimin e kohezionit të sajë, si dhe tensionet të cilat lajmërohen në to.

Duke shikuar aspektin teorik, qëllimi primar i hulumtimit do të jetë që të definohet struktura sociometrike e grupeve brenda ekipes së hendbollistëve dhe në këtë mënyrë të kontribohet në zgjërimin e njohurive shkencore mbi bashkëpunimin e hendbollistëve gjatë lojës.

Detyrat e hulumtimit janë:

- të konstruktohet pyetsori sociometrik,
- të kryhet anketimi i lojtarëve të tri klubevetë hendbollit të Superligës së Kosovës,
- të konstruktohen matricat në bazë të shënimeve nga pyetsori,

# 3. HIPOTEZAT THEMELORE

Në bazë të lëmisë së hulumtimit dhe qëllimit të hulumtimit parashtrohen hipotezat në vijim:

**H1** – Testet sociometrike të aplikuara në tri klube të hendbollit do të tregojnë dhe vërtetojn formimin e dy grupeve të ndryshme, duke pasur parasysh raportet specifike në secilin grup.

**H2** – Në të tri ekipet e hendbollit pritet të lajmrohen yjet pozitiv dhe negative.

# 4. METODOLOGJIA E PUNËS

## 4.1. MOSTRA ETË TESTUARVE

Në punim është aplikuar hulumtimi transferzal i karakterit eksperimental. Shënimet prej rëndësie të vaçant për këtë punim do të grumbullohen me anë të teknikës së anketimit..

Hulumtimi është realizuar në tri klube të të superligës së Kosovo's në hendboll: KH “Drita” nga Gjilani, KH “Prishtina” nga Prishtina dhe KH “Kastrioti” nga Ferizaji. Gjatë periudhës prej 25.09. 2017 deri 30.09. 2017. Në këtë hulumtim janë përfshihirë 45 lojtarë (nga 15 hendbollist prej secilës ekipë përpos ekipes).

Hendbollistët para plotësimit të testit të pyetsorit sociometrik do të njoftohen me natyrën e hulumtimit me të gjitha hollësit relevante për shënimin e të dhënave në pyetsor. Testi sociometrik është i përbër nga pyetsori anonim me tri kriteriume të përbëra prej 13 pyetjeve. Struktura sociometrike është definuar në bazë të shënimeve të fituara nga testi sociometrik duke aplikuar teknikën e emrimit sipas kriteriumit funksional dhe emotiv. Pasqyra tabelare do të na mundësoj shikim detal në strukturën sociometrike të çdo ekipe.

## 4.2 MOSTRA E VARIABLAVE

### 4.2.1 Mostra e variablave dhe mënyra e matjes së testeve sociometrike.

Variablat socimetrike janë definue në këtë mënyrë:

- Indeksi individual sociometrik: indeksi i statusit të zgjedhjes ISZ dhe indeksi i statusit të refuzimit ISR janë definuar në bazë të rezultateve të fituara nga pyetsori sociometrik (votave pozitive dhe negative të çdo individi).
- Indeksi grupor sociometrik: indeksi i kohezionit grupor IKG dhe indeksi i tendosjes grupore ITG janë definue në bazë të rezultateve të fituara nga pyetsori sociometrik (numrit të përgjithshëm të zgjedhjeve negative dhe numrit të zgjedhjes së ndërsjellt pozitiv).
